



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:278310
Datë: 27.11.2024
Numri i dokumentit: 06520526

Kom.Dh.Shk.II.nr.1464/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave ‘Ambienti’ Sh.A me NUI:810538027, me seli në Pejë, rruga ‘Xheme Sadrija’ Fusha e Pejës rr. Tranzit, kundër debitorit Barnatore Xh.S. me numër te konsumatorit 21578, me seli në Pejë, Rr.’’Mehmet Bajraktari’’ p.n me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Pejë- Departamenti i Përgjithshëm Civil, Ep.nr.433/21 të datës 04.03.2022, me datë **27.11.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Barnatore Xh.S., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Pejë- Departamenti i Përgjithshëm Civil, Ep.nr.433/21 të datës 04.03.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, me aktvendimin Ep.nr.433/21 të datës 04.03.2022, në dispozitiv e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, Barnatore Xh.S. të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit

Privat P.nr.904/20 të dt. 30.10.2020 të përmbauesit privat Zija Bala me seli në Pejë, dhe mbetet ne fuqi urdhri përmbauesit Privat P.nr. 904/20 të dt. 30.10.2020 të përmbauesit privat Zija Bala me seli në Pejë.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbauese dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe për shpenzimet e procedurës me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm Civil, Ep.nr.433/21 të datës 04.03.2022.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbauese si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbaues ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm- Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.21578, nga data 01.09.2003 deri me datë 30.09.2019, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Barnatore Xh.S., që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,931.57 €,

Përmbauesi Privat Zija Bala me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaues të kreditorit me urdhrin përmbaues P.nr.904/20 të datës 30.10.2020.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbauesit, brenda afatit ligjor, përmes të autorizuarit të tij ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbauesit me arsyetimin se urdhri për përmbaues është i kundërligjshëm, për shkak të aplikimit të gabuar të nenit 29 par.1 nën par 1.2, nenit 30 lidhur me nenin 21, nenit 70 lidhur me nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se në bazë të nenit 341, 343 dhe nenit

352 të LMD-së, borxhi sipas dokumentit në bazë të cilit është marrë urdhri për përmbarim është parashkruar. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi prapsim i debitorit dhe të Anulohet Urdhri Përmbarimor P.nr.904/20 të datës 30.10.2020, i lëshuar nga përmbaruesi privat Zija Bala.

Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm Civil, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar Ep.nr.433/21 të datës 04.03.2022, ku ka refuzuar prapësimin e debitorit Barnatore Xh.S. me seli ne Peje rr. Mehmet Bajraktari. Urdhrit Përmbarimor P.nr.904/20 të datës 30.10.2020, të Përmbaruesit Privat Zija Bala ka lënë në fuqi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë të pa qëndrueshëm dhe të pa bazuara me ligj, sepse nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të tyre siç është para me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhrit të përmbarimit të përcaktuar me nenin 71 par. 1 deri në 12, as për shtyrjen e zbatimit të përmbarimit sipas nenit 61 të LPP-së. Vlen të ceket se sipas vlerësimit të gjykatës, ne rastin konkret Kartela e Konsumatorit - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me nr. K21578 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në origjinal. vlerëson se pretendimet e debitorit në prapësim, sa i përket detyrimit janë të paqëndrueshme, andaj të njëjtin e refuzoj.

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës nuk u provuar se debitori ka ofruar ndonjë dëshmi me te cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimin sipas dokumenti te besueshëm bazë të së cilës kërkohet shuma prej 1,931.7, andaj ne bazë te neni 69 par.4 te LPP-së. Prapësimi duhet te mbështetur në prova të duhura përndryshe prapësimi refuzohet. Po ashtu marr parasysh faktin se debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjti ka paraqitur ndonjë ankesë ndaj kreditorit për faturën e lëshuar nga kreditori gjykata vendos si ne dispozitat me lartë.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet e debitori se ka lëshuar lokalin në Shtator 2010, mirëpo i njëjti gjykatës nuk i ka dëshmuar me asnjë provë

të vetme se nuk ka qen ne posedim të lokalit për te cilën është inkasuar detyrimi. Prandaj me dispozita ligjore të nenit 29 par. pika 1.2 te LPK-së është përcaktuar se: përmbarimi me qellim te realizimit te kërkesë në të holla caktohet në baze të dokumentit te besueshëm me sipas këtij ligji ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale te furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave e ne bazë te cilit e ka mbështetjen ligjore urdhri për përmbarim.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1464/24, me datë 27.11.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami